



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

## Zyra e Kryetarit

01-104/02-22375/20  
Kaçanik, dt. 10.09.2020

### LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

DATË/A:	10. 09. 2020
PËR/ZA/TO:	z. Besim Ilazi; Kryetar i Komunës z. Festim Neziraj; drejtor i Administratës Komunale
KOPJE/CC	Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
NGA/OD/FROM :	Menduh Krasniqi; Koordinator për Performancë Komunale
TEMA / SUBJEKAT/ SUBJECT:	<b>RAPORT</b> <b>i Performancës Komunale për vitin 2019</b>

### Hyrja

Raporti i performancës komunale prezanton rezultatet e komunave nëpërmjet 19 fushave të kompetencave që janë nën përgjegjësi të tyre. Vitin e kaluar, Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK) kaloi nëpër një proces të rishikimit të plotë, ashtu siç ishte paraparë në planin vjetor të punës së ministrisë. Objektivi i zhvillimit të sistemit ishte përfshirja e sa më shumë fushave të kompetencave komunale dhe treguesve që synonin së pari të pasqyronin gjendjen reale të ofrimit të shërbimeve publike dhe së dyti rezultatet e fituara të shërbenin si burime të rëndësishme të të dhënave për përmirësim të qeverisjes në sektorët në nevojë.

Procesi i rishikimit prodhoi ndryshime të dukshme si nga përmbajtja e komponentëve të matjes, ashtu edhe për nga rregullativa juridike. Në hap me rishikimin e sistemit, u hartua Rregullorja e re për sistemin e menaxhimit të performancës komunale. Me këtë rregullore u integrua edhe skema e grantit të bazuar në performancë. Njëherësh u përcaktuan dispozitat për vënien në funksion të sistemit elektronik për menaxhimin e të dhënave për performancë. Për më tepër, nga një sistem me 14 fusha dhe 77 tregues, sistemi u zgjerua në 19 fusha që përmbajnë 119 tregues.

Edhe në këtë cikël të matjes dhe vlerësimit të punës së komunave, shtrirja e të dhënave reflekton të arriturat e komunave në kuadër të treguesve, rezultateve (nën objektive) dhe fushave sipas kompetencave vetanake përkatëse.

Performanca komunale bazohet në të dhënat e ofruara dhe të dokumentuara nga vetë komunat. Ky raport bën prezantimin e të arriturave vetëm për vitin 2019, por në shumë raste nxjerr krahasime me vitet e mëparshme. Raporti synon të vë në pah dy çështje kryesore të menaxhimit të çështjeve publike: 1) Mënyrën e qeverisjes së komunave vlerësuar sipas legjislacionit të zbatueshëm dhe 2) Ofrimin e shërbimeve në aspektin sasior dhe cilësor, kur është e mundur.

Të dhënat shërbejnë për të pasqyruar performancën brenda komunës, për të ngritur krahasime rreth trendit të zhvillimit të qeverisjes lokale në përgjithësi dhe përmbajnë elemente të rëndësishme të llogaridhënies së të zgjedhurve lokal para qytetarëve. Gjithashtu, raporti informon qytetarët për pritjet e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve nga institucionet e tyre lokale.

Pavarësisht rezultateve, është në autoritetin e institucioneve lokale që të vendosin për prioritetet e tyre të punës, mënyrën e ofrimit të shërbimeve për qytetarët dhe angazhimin e burimeve përkatëse. Raporti nxjerrë përfundimet e përgjithshme për shkallën e të arriturave të komunave dhe jep rekomandimet përkatëse për përmirësimin e shërbimeve në bazë të rregullave juridike në fuqi apo standardeve të kërkuara qeverisëse.

## Qëllimi

Matja e performancës nuk ka të bëjë thjesht me mbledhjen e të dhënave që lidhen me një qëllim afatshkurtër të menaxhimit. Qëllimi i kësaj matje është të nxjerr në pah fushat ku shërbimet komunale kanë nevojë për mbështetje dhe avancim si dhe fushat ku duhet orientuar investimet afatmesme dhe afatgjata. Të dhënat mund të ndihmojnë komunat të përmirësojnë planifikimin dhe të orientojnë prioritetet e tyre në sektorët e nevojshëm për vitet e ardhshme.

Sistemi shërben edhe për autoritetet qendrore për të planifikuar projektet sipas vlerësimeve reale, kritereve të bazuara në nevojën për investime dhe shpërndarjes më të drejtë të parasë publike.

Edhe pse ky sistem vjen me një grant të performancës të përbërë nga buxheti i Ministrisë dhe buxhetet e donatorëve, efekti më i madh i rritjes së performancës mund të jetë si rezultat i evidentimit, krahasimit dhe publikimit të të dhënave të fushave të ndryshme të qeverisjes. Në fakt, matja e performancës synon të jap përgjigje në pyetjet se:

- Në çfarë niveli kanë performuar komunat?
- Nëse komunat po i arrijnë objektivat e tyre?
- Nëse proceset menaxhuese janë në pajtim me ligjin?
- Cilat duhet të jenë veprimet e nevojshme që duhet bërë në të ardhmen?

Prandaj, përmes vlerësimeve të tilla dhe monitorimit të punës së administratës në përgjithësi, apo edhe të zgjedhurve lokal, supozohet të rritet niveli i përgjegjësisë dhe llogaridhënies, ashtu që e gjithë kjo të reflektoj në qeverisje më të mirë dhe shërbime sa më cilësore.

## 2. Përmbledhje e performancës sipas komunave


Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale është një platformë e gjerë për mbledhjen, sistemimin, analizimin dhe raportimin e të dhënave të komunave në fusha të ndryshme të kompetencave vetanake të komunave. Matja e performancës së komunave ka ndikim të shumanshëm, e sidomos në përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve. Studimet e bëra nga Organizata për Bashkërendim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) për reformat e shërbimit civil në 29 vende të ndryshme të botës, është parë se menaxhimi i performancës është faktori kryesor në shumë raste, veçanërisht në arritjen e objektivave të institucioneve. Për më shumë, matja dhe vlerësimi i performancës i ndihmon komunat në përvetësimin e përvojave brenda komunale por edhe ndërmjet komunave duke e krahasuar punën e tyre prej vitit në vit dhe duke krijuar mundësinë e përmirësimit të punës së tyre.

Vlerësimi i këtij viti ka pasur në fokus pasqyrimin e të arriturave për 38 komuna. Kërkesës për raportim i janë përgjigjur 36 komuna, me përjashtim të Komunës së Mamushës dhe Dragashit të cilat nuk kanë dorëzuar formularët e raportimit. Rangimi i komunave është bërë duke marrë parasysh nivelin e të arriturave sipas treguesve. Kjo për shkak se vlerësimi sipas treguesve është konsideruar të jetë më objektiv për shkak të peshës që kanë, i ndikuar nga volumi i tyre brenda fushës së caktuar.

Për dallim nga periudha paraprake, në përgjithësi nuk vërehen ndryshime të komunave sipas performancës së arritur. Mesatarja e përgjithshme e komunave sipas treguesve është 61.16%. 22 komuna kanë arritur performancë mbi mesataren e përgjithshme, derisa 13 komuna janë nën mesataren.

Në vijim është paraqitur figura e radhitjes së komunave sipas performancës së treguesve:

## Performanca e komunave sipas treguesve në %



Figurë 1 Përqindja e arritur e komunave në 119 tregues

## RAPORTI I PERFORMANCËS PËR KOMUNËN E KAÇANIKUT

### Performanca e përgjithshme

Performanca e përgjithshme e komunës së Kaçanikut në 19 fusha të matjes është 71.74% dhe radhitet në mesin e komunave me arritje të lartë të performancës.

Komuna e Kaçanikut, është kualifikuar dhe ka arritur të fitoj grantin në vlerë prej 263,270.21 euro, i cili do të alokohet në vitin 2021.

Pas procesit të verifikimit të plotë të të gjitha të dhënave, komuna ka dërguar dëshmitë e kërkuara dhe gjatë procesit të plotësim/ndryshimeve është vërtetuar se të gjitha dëshmitë e kërkuara janë dërguar me kohë në MPL.

Fusha me performancën më të lartë është fusha e transparencës komunale, me 100% të treguesve të përmbushur, derisa fusha me performancën më të ulët është Parkingjet Publike me vlerën prej 39.48%. Performancë e lartë është treguar edhe në fushën e Përgjegjshmërisë Komunale 88.17%. Fushat për të cilat duhet t'iu jepen prioritet janë: Shëndetësia Primare 46.68% si dhe fushat e tjera me performancë jo të kënaqshme.

### Performanca sipas fushave:

Nr	Fusha	Vlera në %
1	Shërbimet Publike Administrative	65.77
2	Transparenca Komunale	100
3	Përgjegjshmëria Komunale	80.74
4	Barazia për punësim, shërbimet sociale dhe familjare	69.53
5	Kulturë, rini dhe sport	63.85
6	Menaxhimi i fatkeqësive	82.74
7	Planifikimi hapësinor	75.04
8	Hapësirat publike	53.79
9	Infrastruktura rrugore	54.21
10	Transporti publik	74.35
11	Parkingjet publike	39.48
12	Uji i pijshëm	84.74
13	Kanalizimi	56.49
14	Menaxhimi i mbeturinave	89.48
15	Mbrojtja e ambientit	83.81
16	Përfaqësimi gjinor	60.89
17	Arsimi para universitar	63.47
18	Kujdesi primar shëndetësor	53.73
19	Zhvillimi ekonomik lokal	85.25

### **Fusha 1. Shërbimet Publike Administrative**

Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 65.77%. Gjatë vitit 2019 nga qytetarët ishin parashtruar gjithsej 41122 kërkesa apo lëndë për komunën, ndërsa komuna shqyrtoi 40022 prej tyre apo 97.33% e tyre, ndërsa pjesa tjetër nuk është shqyrtuar apo ka mbetur për shqyrtim në fazat e mëvonshme. Kërkesat e parashtruara për të cilat ka pasur proces të shqyrtimit administrativ nga komuna, kanë përfunduar brenda afatit ligjor.

Komuna edhe për gjatë vitit 2019 ka raportuar se nuk ka arritur të ofrojë shërbime administrative në mënyrë elektronike. Prandaj siç është raportuar edhe nga komuna niveli i performancës në këtë tregues mbetet 0.

### **Fusha 2. Transparenca Komunale**

Përqindja e arritur e performancës në këtë fushë është 100%. Të gjitha mbledhjet e kuvendit komunal ishin bërë publike dhe po ashtu pas verifikimit u konstatua se mbledhjet e kuvendit ishin transmetuar në ueb faqen e komunës.

Komuna ka raportuar se nga 21 kërkesa të qytetarëve për qasje në dokumente publike në komunë, gjatë vitit komuna ofroi qasje në të gjitha dokumentet e kërkuara nga qytetarët.

Komuna në ueb-faqen e saj ofron të dhëna të përditësuara për veprimtaritë publike të saj. Por ashtu komuna ka raportuar se ofron qasje online në strategji dhe dokumente tjera të politikave në fushë veprimtarinë e institucionit publik. Komuna kishte paraqitur Planin vjetor të prokurimit publik. Vendimet e kuvendit të komunës dhe të kryetarit të gjitha po ashtu janë publike. Komuna ka publikuar 28 kontrata të lidhura me kompani aq sa ishin gjithsej gjatë vitit 2019.

### **Fusha 3. Përgjegjshmëria Komunale**

Performanca komunale në këtë fushë është arritur në nivelin 80.74%.

Komuna ka plotësuar kushtin që për së paku dy takimet publike të bëjnë njoftimin me kohë dhe në gjuhët zyrtare të komunës.

242 qytetarë kanë marrë pjesë në konsultimet publike nga gjithsej 33,409 banorë të komunës. Nga 4 akte të miratuara në kuvendin komunal të cilat ishin me interes të përgjithshëm, komuna kishte organizuar konsultime me publikun. Komuna po ashtu ka plotësuar numrin e mjaftueshëm të konsultime publike për buxhetin vjetor komunal duke mbajtur tre takime. Po ashtu u mbajtën 3 konsultime publike për Kornizën Afatmesme të Buxhetit, numër ky i mjaftueshëm krahasuar me numrin e banorëve në komunë.

Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike është vlerësuar me 0, kjo ngase të njëjtat nuk janë gjetur në ueb faqe.

Në komunën e Kaçanikut funksionojnë 33 këshilla lokal nga gjithsej 31 vendbanime në komunë. Por, komuna ka raportuar se asnjë nga këshillat lokal të themeluar në mandatin aktual nuk ka mbajtur së paku 6 takime brenda vitit raportues.

Kryetari i komunës ka dorëzuar para datës 1 shtator buxhetin për miratim dhe Kuvendi Komunal e ka miratuar me kohë. Kuvendi Komunal ka mbajtur të gjitha

diskutimet për raportet buxhetore tre-mujore dhe po ashtu diskutoi Raportin e Performancës Komunale nga viti paraprak.

Po ashtu në Asamblenë Komunale, është diskutuar raporti i Auditorit të Jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve nga ZKA. Raporti i Auditorit të brendshëm u diskutua nga kuvendi por nuk u diskutua edhe plani i veprimit lidhur me këtë raport. Në vitin raportues u mbajtën 12 mbledhje të kuvendit, ku në të gjitha prej tyre ishte prezent kryetari i komunës.

Komuna e Kaçanikut me rastin e raportimit ka deklaruar se e tejkaloi vlerën e shpenzimeve të paraparë me planin e prokurimit. Vlerat e raportuara mbi 100%, si rregull i raportimit do të rrumbullakohen në 100. Të gjitha Pagesat komuna i ka proceduar brenda afatit ligjor prej 30 ditëve, pra gjithsej 2856 pagesa.

Plani i integritetit u raportua nga kryetari para kuvendit komunal më kohë. Komuna shpërndau vlerësimet e performances për të gjithë zyrtarët komunal dhe të gjitha vendet e reja të punës janë procesuar përmes SIMBNj, po ashtu të gjitha kontratat për shërbime të veçanta janë në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

#### **Fusha 4: Barazia në Punësim, Shërbimet Sociale dhe Familjare**

Performanca e përgjithshme e kësaj komunë në këtë fushë është 69.53%.

Komuna e Kaçanikut ka 3 të punësuar me aftësi të veçanta nga gjithsej 800 punonjës të institucioneve komunale. Në bazë të dhënave të ASK-së Komuna e Kaçanikut ka gjithsej 33409 banorë prej të cilëve 33402 Shqiptarë dhe 7 banorë nga komunitetet tjera. Komuna nuk ka ndonjë të punësuar nga komunitetet jo/shumicë.

#### **Fusha 5: Kulturë Rini dhe Sport**

Totali i përqindjes së arritur në fushën Kulturë, Rini dhe Sport është 63.85%.

Komuna ka në menaxhim 18933.38 m<sup>2</sup> hapësira sportive. Komuna ka organizuar gjithsej 46 aktivitete kulturore, rinore dhe sportive duke përmbytur 100% të standardit të kërkuar në raport me numrin e popullsisë. 34.90% është vlera e treguesit të pjesëmarrjes së qytetarëve në aktivitete kulturore, rinore dhe sportive apo 3070 pjesëmarrës në aktivitete Kulturore, Rinore dhe Sportive.

#### **Fusha 6: Menaxhimi i Fatkeqësive**

Përqindja totale e arritur në këtë fushë është 82.74%. Niveli i përgjithshëm i realizimit të Planit Komunal për Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore dhe të tjera është konstatuar të jetë realizuar në shkallën 66.67% apo gjithsej nga 9 veprime të parapara në këtë plan gjithsej u realizuan 6 veprime.

Numri i fatkeqësive gjatë vitit 2019 në komunën e Kaçanikut ishte 255 dhe në 252 kishin intervenuar njësitë përgjegjëse komunale apo në 98.82% të kërkesave për intervenim.

#### **Fusha 7: Planifikimi Hapsinor**

Komuna e Kaçanikut ka një territor prej 211km<sup>2</sup>, apo 21100 ha, prej tyre 40 ha janë të mbuluara me plane rregulluese të hollësisë, apo 0.2% e totalit të komunës.

Përqindja totale e arritur në këtë fushë është 75.04%

Komuna ka pasur gjithsej 40 kërkesa për leje ndërtimore të gjitha të shqyrtuara me kohë në vitin raportues. Komuna ka inspektuar 100% të 29 objekteve të reja të ndërtuara gjatë vitit të raportimit, të cilat rezultuan me leje ndërtimore.

#### **Fusha 8: Hapësirat Publike**

Performanca e arritur e komunës në këtë fushë është 53.79%

Sipas të dhënave Komuna ka gjithsej 4.62 ha hapësira të gjelbra dhe komuna ka raportuar se sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht nga komuna është 4.62 ha apo 100% e tyre. Komuna ka 1.4m<sup>2</sup> hapësira të gjelbra për kokë banori. Komuna e Kaçanikut numëron gjithsej 15 hapësira publike ku nga to 9 janë të përcjella me ndriçim publik.

#### **Fusha 9: Infrastruktura Rrugore**

Performanca e përgjithshme e komunës në këtë fushë është 54.21%. Komuna ka 267.69 km rrugë të shtruara në asfalt nga gjithsej 332.37km rrugë apo 81.57%, kurse 27.61km janë asfaltuar gjatë vitit raportues. 267.69km rrugë mirëmbahen gjatë sezonës së verës dhe të dimrit, apo të gjitha rrugët e asfaltuara të komunës. 11.86% e rrugëve urbane dhe në vendbanime në fshatra janë të pajisura me trotuare. Nga totali i 267.69km rrugë të asfaltuara sa ka kjo komunë 36 km janë të pajisura me ndriçim publik apo 13.45% e rrugëve. Gjithsej 71.85km rrugë apo 26.84% e totalit të rrugëve janë të pajisura me shenjëzim horizontal dhe vertikal. Komuna nuk ka fare shteg të biçikletave në zonën urbane. Komuna kishte planifikuar për riasfaltim 1.7km rrugë ku që të gjitha i realizoi gjatë vitit raportues.

#### **Fusha 10: Transporti Publik**

74.35% është performanca e përgjithshme në këtë fushë. Nga 6 veprime të parapara në Planin Komunal për Transport Publik, të gjitha janë realizuar. 24 vendbanime janë të përfshira në transportin publik lokal nga 31 vendbanime sa ka kjo komunë apo 77.42% e vendbanimeve. 45.65% e vendndalimeve për automjetet e transportit publik janë të shenjëzuara për automjetet e transportit publik, apo 42 nga 92 vendndalime në territorin e komunës së Kaçanikut.

#### **Fusha 11: Parkingjet Publike**

Performanca e komunës në këtë fushë është 39.48%. Komuna ka 12 parkingje publike me 414 vendparkingje, në këtë mënyrë e arritura në këtë tregues është 7.05% duke marrë parasysh se në komunë janë të regjistruara 5874 mjete motorike. Në Komunën e Kaçanikut janë të regjistruar gjithsej 36 taksi dhe komuna ka raportuar se ka të rezervuar gjithsej 32 vendparkingje të destinuara për taksi duke arritur kështu vlerën 88.89%, nga 12 parkingje publike 6 vendparkime janë të rezervuara për persona me aftësi të kufizuar duke arritur performancë prej 50% në tregues.

#### **Fusha 12: Uji i Pijshëm**

Në vitin 2019 komuna kishte të arritura në këtë fushë në vlerën 84.74%.

Komuna ka planifikuar dhe realizuar 6 projekte në rrjetin e ujësjellësit. Në komunë janë të regjistruara 5547 ekonomi familjare, ku prej tyre 4373 janë të përfshira në

sistemin e ujit të pijshëm. Nga 40 institucione publike në komunë të gjitha janë përfshirë në sistemin e ujësjellësit.

### **Fusha 13: Kanalizimi**

Të arriturat e komunës në këtë fushë janë në nivelin 56.49%. Komuna ka ndërmarr 5 veprime sa i përket ndërtimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të kanalizimit, po aq sa ishin paraparë më planin për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit. 4373 ekonomi familjare janë të përfshira në sistemin e kanalizimit, 40 institucione publike dhe 370 ekonomi biznesore dhe të ngjashme, apo gjithsej 69.48% e ekonomive familjare, institucioneve publike dhe ekonomive biznesore e të tjera së bashku. Asnjë nga vendbanimet e komunës nuk është përfshirë në sistemin e trajtimit të ujërave të zeza.

### **Fusha 14: Menaxhimi i Mbeturinave**

E arritura e komunës në këtë fushë është në nivelin 89.48%.

Të tre veprimet e parapara me Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave u realizuan gjatë vitit raportues. Në Komunën e Kaçanikut nga gjithsej 5547 ekonomi familjare, 3065 e tyre kanë qasje në sistemin e grumbullimit të mbeturinave apo 58.05% e totalit të ekonomive familjare të komunës dhe gjitha institucionet publike. Në komunën e Kaçanikut janë inkasuar 89.40% e mjeteve të faturuara për menaxhimin e mbeturinave. Komuna ka arritur të deponoj 100.28 kg mbeturina në vit për kokë banori. Vlerësimi bëhet kundër një mesatare standarde minimale të mbeturinave të deponuara në Bashkim Evropian (BE) që është 300kg mbeturina të deponuar për person në vit.

### **Fusha 15: Mbrojtja e Ambientit**

Komuna ka arritur në këtë fushë performancë në nivelin 83.81%. Komuna ka realizuar Planin Lokal të Veprimit në Mjedis në masën 71.4% duke realizuar 5 nga 7 veprimet e planifikuara. Komuna ka lëshuar 3 leje mjedisore gjatë vitit 2019. 3 objekte të reja kishin kërkuar lejen mjedisore të gjitha ishin inspektuar nga komuna dhe ishin pajisur me leje.

### **Fusha 16: Përfaqësimi Gjinor**

E arritura në këtë fushë është në masën 60.89%. Nga gjithsej 800 të punësuar në institucionet komunale 312 janë gra. 11 nga 35 zyrtarë të lartë në pozita udhëheqëse në institucionet komunale janë gra duke arritur performancë prej 62.86%. 4 gra janë të emëruara në pozita politike në komunë nga gjithsej 12 zyrtarë në pozita politike. Në pjesëmarrjen e grave në komitete dhe komisione komunale komuna shënon të arritura në masën e treguesit prej 95%. Në këshillat lokal të themeluar nga komuna pjesëmarrja e grave është në nivelin 24.62%, ku nga 33 këshillat lokal të themeluar asnjë nuk udhëhiqet nga gratë. Sa i përket buxhetimit për gratë përqindja qëndron në masën 32.55% nga të dhënat e treguesit. 99 nga 242 pjesëmarrës në takimet publike të organizuara nga komuna ishin gra dhe vajza. 15 nga 283 rrugë të emërtuara sipas personaliteteve, mbajnë emra grash. 56 nga 316 prona të

regjistruara total në komunë janë të regjistruara në emër të dy apo më shumë personave me gjini të ndryshme.

### **Fusha 17: Arsimi Para Universitar**

E arritura në nivelin e performancës së komunës në Fushën e Arsimit Para Universitar është 63.47%.

Treguesi m<sup>2</sup> të hapësirave për nxënës llogaritet në proporcion me vlerën më të madhe të këtij treguesi në nivel të Kosovës. Si rezultat i kësaj llogaritjeje % në këtë tregues ka arritur 22.20%. Komuna ka gjithsej 1 çerdhe ndërsa nuk ka asnjë çerdhe në zonat rurale. Komuna ka raportuar se ka mesatarisht 2.6m<sup>2</sup> hapësira për nxënës në institucionet arsimore. Në komunë vijojnë institucione arsimore të nivelit ISCED 02, 1, 2, dhe 3 gjithsej 3522 nxënës nga vendbanimet urbane me gjithsej 8982m<sup>2</sup> hapësira të institucioneve arsimore në këto zona dhe 3402 nxënës nga vendbanimet rurale me gjithsej 10285m<sup>2</sup> hapësira të institucioneve arsimore në këto vendbanime.

10 nga 14 shkolla janë të pajisura me kabinete të TIK-ut apo 71.43%, 2 kanë sallë të edukatës fizike, 8 shkolla janë të pajisura me kabinete, laboratorë, punëtori dhe ushtrimore me pajisje, mjete dhe material shpenzues ku mundësohet zbatimi i mësimin të bazuar në kabinete dhe laboratorë. Kurse po ashtu 8 nga 14 shkolla kanë masa të efijencës së energjisë apo 57.14% e tyre, 5 shkolla janë të pajisura me kamera dhe gardhe të sigurisë. Të gjitha shkollat janë të pajisura me klasa të zakonshme të pajisura me orëdi të domosdoshme shkollore si dhe me mjete elektronike për zhvillimin e aktivitetit mësimor (projektor, tabela elektronike).

Komuna ka gjithsej 480 mësimdhënës ku nga ta 400 janë të licencuar apo 83.33% e tyre. Të gjitha vendet e reja të punës për mësimdhënës dhe drejtorë ishin plotësuar me konkurs të rregullt. Mesatarja e arritshmërisë në testin e arritshmërisë për klasat e 9-ta në komunën e Kaçanikut është 49.8% ku vajzat kishin kalueshmërinë në nivelin 50%. Ndërsa kalueshmëria në testin kombëtarë të maturës ishte në nivelin 62.90%, apo 330 nga 525 nxënës që i janë nënshtruar testit. Asnjë nxënës nuk e ka braktisur shkollën. 97.60% e orëve të parapara sipas kalendarit vjetorë të arsimit ishin realizuar.

### **Fusha 18: Kujdesi Primar Shëndetësor**

Performanca e arritur e komunës në këtë fushë është në nivelin 53.73%.

Komuna e Kaçanikut ka gjithsej 3339m<sup>2</sup> hapësira të kujdesit primar shëndetësorë. Përqindja e këtij treguesi llogaritet në proporcion me vlerën më të madhe të këtij treguesi në nivel të Kosovës dhe performanca e komunës arrin vlerën 78.07%.

Nga 13 njësi të mjekësisë familjare vetëm 1 i përmbush kërkesat për inventar, mjete dhe ofrimin e shërbimeve laboratorike. Në komunën e Kaçanikut janë 5 ekipe të mjekësisë familjare [1 mjek specialist dhe 2 infermier].

1.93% e buxhetit për kujdes primar shëndetësor mbulohet nga komuna apo 19,316.99 Euro.

88.60% e fëmijëve ishin përfshirë në programin e imunizimit apo ishin imunizuar 2281 nga 2575 fëmijë të moshës së imunizimit.

### Fusha 19: Zhvillimi Ekonomik Lokal

Performanca e kësaj fushe është 85.25%.

Komuna ka raportuar për miratimin dhe zbatimin e Planit për Zhvillim Ekonomik Lokal.

Lista e përgatitur dhe e përditësuar me prona - nuk është bërë përgatitja dhe publikimi në ueb-faqe listës së pronave të planifikuara në shfrytëzim, siç parashihet me nenin 13 të Ligjit Nr. NR. 06/L-092 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS. Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime) është në nivelin 41 % apo 124,500 Euro nga vlera totale e faturuar vjetore prej 303,451.21 Euro.

#### REKOMANDIM:

Raportimi sipas SMPK-së është bërë në 19 fusha me 119 tregues.

Sipas vlerësimit të koordinatorit komunal, Komuna e Kaçanikut në këtë vit duhet të fokusohet në përmirësimin dhe ngritjen e % në këto tregues të fushave të caktuara:

Fusha	Treguesi	Raporti SMPK-së
1	1.1.4 Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna	0.00 %
3	3.1.2 Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike	24.15%
3	3.1.5 Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike	0.00 %
3	3.1.7 Intervenimet në mbledhjen e mbeturinave nga raportimet e qytetarëve	31.03
3	3.2.8 Intervenimet në shpërthimet në ujëra të zeza	27.45%
3	3.2.5 Diskutimi i raportit të auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit në asamblenë komunale	50%
3	3.3.3 Niveli i adresimit të rekomandimeve të zyrës kombëtare të auditorit	42.86%
3	3.3.5 Kontratat për shërbime të veçanta janë në pajtueshmëri me kornizën ligjore	36.84%
5	5.2.2 Pjesëmarrja e qytetarëve në veprimtari për kulturë, rini dhe sport	34.90%
7	7.1.1 Sipërfaqja e territorit të komunës i mbuluar me plane rregulluese (të hollësishme)	0.20%
8	8.1.1 Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në m <sup>2</sup> për kokë banori	1.40
8	8.1.3 Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik	60.00%
9	9.2.1 Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare	11.86%
9	9.2.2 Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik	13.45%
9	9.2.3 Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjzim vertikal dhe	26.84%

	horizontal	
9	9.2.4 Rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave	0.00%
11	11.1.1 Numri i parkingjeve për parkimin e mjeteve motorike	12.00%
11	11.1.2 Vendparkimet për mjete motorike në territorin e komunës	7.05%
13	13.2.1 Vendbanimet e përfshira në sistemin për trajtim të ujërave të zeza	0.00%
16	16.1.5 Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale	24.62%
16	16.2.2 Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave	32.55%
16	16.3.1 Barazia gjinore tek emërtimet e rrugëve	10.60%
16	16.3.2 Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive	17.72%
17	17.1.1 Çerdhe dhe kopshte në zona rurale për 10000 banorë	0.00%
17	17.1.2 m <sup>2</sup> të hapësirave për nxënës – urban dhe rural	22.20%
17	17.2.3 Plotësimi i buxhetit për arsim prej të hyrave vetanake	2.92%
18	18.1.2 Objektet e KPS që janë të pajisura sipas udhëzimit administrativ edhe shërbimet laboratorike	7.69%
18	18.2.1 Niveli i pajtueshmërisë me raportin 1 mjek familjar edhe 2 infermier për 2000 banorë	0.00%
18	18.2.2 Përqindja e buxhetit për kujdes primar shëndetësor të mbështetur nga komunat prej të hyrave vetanake	1.93%

## Konkluzionet dhe rekomandimet e MPL –së për të gjitha komunat

Vlerësimi i performancës komunale për vitin 2019 nxjerr të gjetura të shumta për 19 fusha të kompetencave komunale. Përfundimet e këtij raporti theksojnë një numër të madh të çështjeve, të cilat duhet të merren parasysh dhe trajtohen me prioritet nga organet e pushtetit lokal. Në këtë pjesë të raportit, janë veçuar disa nga konkluzionet dhe rekomandimet me peshë më të madhe në avancimin e shërbimeve komunale. Raporti nxjerr përfundimet se:

1. Vlerësimi i performancës së komunave për vitin 2019 është bërë për 36 komuna të cilat kanë raportuar. Këtij procesi nuk i janë përgjigjur Komuna e Mamushës dhe Dragashit. Disa nga të dhënat e raportuara nga komunat me shumicë serbe, në fushën e arsimit dhe shëndetësisë, të cilat nuk korresponduan me ofrimin e shërbimeve sipas legjislacionit pozitiv të Republikës së Kosovës, janë shpallur zero dhe u aplikua vlera 0% e performancës. Matja dhe vlerësimi i performancës është obligim ligjor i të gjitha komunave, të cilat duhet t'i përgjigjen kërkesave për informata konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregullores për Sistemin e Menaxhimit të Performancës komunale.
2. Përkundër gjendjes së pandemisë, cilësia e raportimit ka qenë relativisht e mirë. Komunat duhet t'i kushtojnë vëmendje të gjitha të dhënave të prezantuara për raportim, në mënyrë që vlerat e fituara të paraqesin vlerësimin sa më objektiv të performancës për çdo tregues.
3. Dokumentimi i të dhënave është kusht i domosdoshëm. Gjatë përgatitjes së të dhënave dhe informatave, komunat duhet të përgatisin dosjen për secilën fushë. Procesi i sigurimit të cilësisë ka evidentuar një numër të të

dhënave të pasakta, të cilat në shumë raste janë shpallë të pavlefshme, përveç atëherë kur është bërë dokumentimi i tyre.

4. Cilësia e raportimit duhet të rritet në të ardhmen, ashtu që raportimi të jetë i drejtë, i saktë, objektiv dhe të paraqes gjendjen sa më reale të performancës së komunave.
5. Të dhënat e performancës konstatojnë epërsinë e fushës së menaxhimit të fatkeqësive në raport me fushat e tjera. Transparenca komunale shënon vendin e dytë, megjithëse treguesi për pasqyrimin e rezultateve të konsultimeve publike duhet të trajtohet seriozisht nga autoritetet lokale. Komunitat duhet të fillojnë në zbatimin e standardeve të reja minimale për konsultimin publik. Raportet e proceseve të konsultimeve publike duhet të përpilohen për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në politikbërje dhe marrjen e opinionit të tyre për çështje publike.
6. Po ashtu ka nevojë për standardizim të përdorimit të ueb-faqeve zyrtare të komunave. Informatat, raportet dhe dokumentet janë vendosur në menyjo të përshtatshme, duke e bërë shumë të vështirë qasjen në informata. Publikimi i dokumenteve duhet të bëhet sipas menyve (aplikacioneve) specifike për materiale të caktuara.
7. Fusha me performancën më të ulët është kanalizimi. Në këtë fushë komunitat nuk kanë ofruar të dhëna valide për numrin e vendbanimeve të përfshira në sistemin e trajtimit të ujërave të zeza. Pasaktësia e madhe e të dhënave ka bërë që ky tregues të shpallet i pavlefshëm në tërësi, në mënyrë që të mos reflektoj performancë të pavërtetë.
8. Një pjesë e komunave kanë filluar aplikimin online të shërbimeve administrative. Këto shërbime duhet të aplikohen në të gjitha komunitat dhe për numër më të madh të shërbimeve, përfshirë aplikimin online për leje ndërtimore, leje mjedisore, pagesat e tatimit në pronë, apo faturat për shërbime komunale;
9. Vetëm 27.78% e komunave kanë dëshmuar ta kenë diskutuar në Kuvendin e Komunitës planin e integritetit, 32% raportin e auditorit të brendshëm dhe 50% Raportin e performancës komunale për vitin paraprak. Këto plane dhe raporte duhet të bëhen pika diskutimi rutinore për çdo vit në kuvendet komunale me qëllim që të forcohet niveli i përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së ekzekutivit para kuvendit dhe qytetarëve.
10. Të dhënat për shërbimet sociale tregojnë se drejtoritë komunale duhet të jenë më efektive në vlerësimin e familjeve në banim social, në mënyrë që të objektet e banimit social të shfrytëzohen nga familjet në nevojë dhe të ketë shqyrtim të plotë të kërkesave të parashtruara;
11. Planifikimi hapësinor kërkon trajtim më të gjerë për të rregulluar të gjithë sipërfaqet e nevojshme me plane rregulluese të hollësishme. Të dhënat flasin për një shkallë mjaft të ulët të këtyre planeve të cilat janë tejet të rëndësishme për rregullimin e komunitës;
12. Infrastruktura rrugore duhet të kompletohet, si në aspektin e asfaltimit të rrugëve, ashtu edhe me infrastrukturë përcjellëse përfshirë trotuare dhe ndriçim publik. Drejtoritë komunale për infrastrukturë duhet të

- planifikojnë më mirë aktivitetet për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale, përmes kontraktimit të operatorëve përkatës.
13. Gjithashtu, komunat duhet të punojnë në avancimin e infrastrukturës rrugore përmes krijimit të shtigjeve të biçikletave sidomos në zonat urbane si dhe zgjerimin e trotuareve për vendbanimet rurale;
  14. Komunat duhet të planifikojnë dhe bashkëpunojnë për të siguruar trajtim të ujërave të zeza paralelisht me zgjerimin e rrjetit të kanalizimit. Trajtimi i ujërave të zeza është i shprehur në masë tejet të ulët, marrë parasysh koston e lartë të këtij shërbimi. Komunat duhet të shqyrtojnë edhe mundësitë e burimeve të tjera financiare për krijimin e impianteve, në mënyrë që të evitohen shumë probleme mjedisore dhe të mbrohet shëndeti publik.
  15. Sasia e deponimit të mbeturinave në komunat e Kosovës është mjaftë e ulët krahasuar me mesataren e Bashkimit Evropian (për kokë banori) dhe komunat duhet të sigurohen që mbeturinat e grumbulluara të deponohen në deponi legale dhe se ato nuk përfundojnë në deponi ilegale ku nuk regjistrohet si sasi e deponuar.
  16. Gjatë procesit të planifikimit të buxhetit, komunat duhet të përpilojnë dhe të formulojnë pjesën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor sipas kriterëve ligjore. Politikat lokale duhet të vlerësojnë ndikimin gjinor, ashtu që burimet financiare të ndahen proporcionalisht për të dy gjinitë. Kërkohe promovim më i madh i politikave gjinore në këshillat e lokale. Rreth 33% e komunave duhet të hartojnë planet për barazi gjinore. Kriteri i barazisë gjinore duhet të forcohet edhe në kuadër të pozitave të emëruara politike si dhe të promovohet e drejta për regjistrimin e pronësisë në të dy gjinitë e cila qëndron në vlerë mjaft të ulët.
  17. Komunat duhet të fillojnë të investojnë në çerdhe/kopshte në zona rurale ku ka nevojë, për shkak të rëndësisë së këtyre institucioneve në zhvillimin e hershëm të fëmijëve.
  18. Drejtoritë komunale të arsimit duhet të planifikojnë që shkollat të plotësojnë kushtet e infrastrukturës përcjellëse, masat e energjisë eficiente si dhe të jenë të pajisura me kabinate me internet në masë më të madhe. Krijimi i hapësirave shkollore sidomos në zonat urbane kërkojnë trajtim të veçantë për të eliminuar mësimin në më shumë turne dhe aplikimin e mësimit gjithë ditor.
  19. Standardi një mjek familjar dhe dy infermierë për 2000 banorë duhet ngritët ne pajtim me kriteret ligjore;
  20. Planifikimi formal për zhvillim ekonomik lokal duhet të zgjerohet në komuna. Raportimi për realizimin e planeve të tilla duhet të jetë temë e diskutimit në kuvendet komunale, në mënyrë që aktivitetet në këtë fushë të gjejnë zbatim më të lehtë dhe të prioritizohen.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik  
-Kuvendi i Komunës-

01Nr.02-104/02-22375/20  
Kaçanik, 29.09.2020

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 29 Shtator 2020, pos tjerash, u;

#### NJOFTUA

1. Me Raportin e Performancës Komunale për vitin 2019, me tekstin e mëtejme "Raporti i performancës Komunale për vitin 2019".

2. Në Raportin, si në pikën 1 të kësaj shkrese, paraqiten të arriturat e Komunës së Kaçanikut në nivel vendi, nëpërmjet 19 fushave të kompetencave që janë nën përgjegjësi të tyre.

3. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese, është; Raporti i Performancës Komunale për vitin 2019/ Lënda 01Nr.02-104/02-22375/20.

**Më këtë shkrese njoftohen:** Kryetari i Komunës, Drejtorja e Administratës së Përgjithshme dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli

